



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:201796

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05712912

P.nr.311/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit E.U, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1617/22 e datës 31.10.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **25.03.2024**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit E.U se bashku me mbrojtësen e tij av. Pranvera Ukaj-Pukaj, sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 22.04.2024, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

E.U nga i ati B. dhe e ëma Sh. e gjinisë Gj., i lindur me datë ... në fshatin Ll. i B. ku edhe jeton, Komuna I., dhe me vendbanim edhe në shtetin e Gjermanisë, në qytetin Sh., i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer katër vite të shkollës fillore, i punësuar në shtetin e Gjermanisë, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datën 14.08.2022, rreth orës 20:00 në fshatin Ll. i B., Komuna I., përdor armën dhe atë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët (Ligjin Nr.05/L-022 për Armë), në atë mënyrë që ditën kritike gjatë një ahengu familjar, në shtëpinë e tij gjersa gjendej në Kosovë për pushime, gjatë ahengut i njëjti në shenjë gëzimi gjuan përpjetë dy (2) herë me pistoletë për të cilën kishte leje, të llojit TP9SA, prodhim Canik, me nr.serik T6472-18AP07117, Kaliber 9 mm, e cila armë është sekuestruar.

- me çka ka kryer veprën penale **përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42,46, 47, 48, 49, 69, 79 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 459 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- I. Ashtu që, të pandehurit E.U, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, *i cili dënim do të jetë i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet*, nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- **Në të kundërtën**, nëse i pandehuri brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- II. **URDHEROHET** konfiskimi i armës e llojit pistoletë 9x19, model “TP9SA,” kalibër 9mm, prodhuesi “Canik”, me nr. Serik T6472-18 AP 07117; katër fishek të kalibrit 9mm; dy karikator të pistoletës, një karikator i pistoletës “TT”. Te cilat kanë qenë të sekuestruar në këtë çështje penale nga Stacioni Policor në Istog, numri i rastit 2022-DF-446. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të njëjtat duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës.
- III. **URDHEROHET** që të pandehurit E.U, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ti i kthehet në posedim: një pushkë e gjuetisë, e modelit BS-106, kalibër 12 GA, prodhuesi “Stranger”, me nr. Serik 18-2535; një fishek i kësaj pushke të gjuetisë 12 GA; dhe leja për këtë pushkë të gjuetisë me numër Df2008070060276. Te cilat kanë qenë të sekuestruar në këtë çështje penale nga Stacioni Policor në Istog me numër të rastit 2022-DF-446. Meqenëse kjo armë sipas aktakuzës nuk rezulton se është përdorur nga i pandehuri ditën kritike dhe për te cilën ka poseduar lejen valide.
- IV. **OBLIGOHET** i pandehuri që ti paguaj shpenzimet e procedurës, ashtu që, në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej **njëzet (20) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V. Palë të dëmtuar nuk kishte.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1617/22 e datës 31.10.2022, kundër të akuzuarit E.U i akuzuar për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 25.03.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku dhe i pandehuri E.U se bashku me mbrojtësen e tij av. Pranvera Ukaj-Pukaj e caktuar sipas autorizimit, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurit të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri E.U pas konsultimit me mbrojtësen e tij, ka deklaruar se: e pranon fajësinë për shkak të veprës penale për të cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime, dhe i premtun gjykatës se ne te ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar: pajtohem me pranimin e fajësisë të deklaruar nga ana e të pandehurit për veprën penale e cila i bije në barrë, andaj kërkojmë që ky pranim fajësie të aprovohet si i tillë. Meqenëse i akuzuari e pranoj fajësinë konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, ngase pranimin e fajësie e bëri në mënyrë vullnetare, pa ndikim dhe në mbështetje të fakteve të çështjes që përmban aktakuza, nga gjykata kërkoj që të akuzuarin ta shpallë fajtor, ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësja e të pandehurit E.U, av. Pranvera Ukaj - Pukaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj, ka deklaruar se: e mbështesë pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të mbrojturit tim, i cili pranim fajësie është bërë pas konsultimit paraprak me mua si mbrojtëse, i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, meqenëse ky pranim fajësie ka mbështetje edhe në shkresat e lëndës i propozoj gjykatës që të njëjtin pranim fajësie ta aprovuj dhe ky pranim fajësie të merret si rrethanë lehtësuese gjatë marrjes dhe shqiptimit të dënimit, po ashtu si rrethanë lehtësuese të merret pendimi për veprën e kryer dhe asnjëherë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, siç rezulton aktakuza, këtu i mbrojturi im e ka përdorë vetëm pistoletën e cila theksohet në përshkrimin faktik të veprës penale, ndërsa nuk ka përdorë pushkën e gjuetisë e cila ju ka sekuestruar gjatë bastisjes dhe propozojmë që e njëjta t'i kthehet.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimeve të lartcekura, si dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, 2, nën par. 2.1, 2.2, dhe 2.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se

mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale të lartcekur për të cilën është akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve ligjore, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësisë dhe rrethanat personale se është pendur për këto veprime dhe nuk ka qenë i dënuar; ndërsa **rrethana rënduese** gjykata nuk ka gjetur. Prandaj, në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Gjykata, të pandehurit me anë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, i'a tërheq vërejtjen seriozisht dhe i bëhet me dije se nëse kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës kohore të verifikimit, dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

Vendimi për konfiskim

Gjykata konform nenit 367 par.3 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konfiskuar armët dhe sendet tjera të specifikuara si me lartë, të përdorura nga i pandehuri në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët.

Vendimi për kthimin e sendeve të sekuestruara

Gjykata duke u vepruar konform nenit 113 të KPP-së, dhe ne referim te propozimit te mbrojtësit të pandehurit për kthimin e armës së gjuetisë e cila nuk është përdorur nga i pandehuri ditën kritike, dhe meqenëse e njëjta armë ne aktakuze nga prokuroria nuk është theksuar se është përdorur nga i pandehuri ditën kritike, si dhe gjykata nuk ka gjetur as bazë ligjore për konfiskim të përhershëm të të njëjtës, andaj vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, qe e njëjtat se bashku me sendet përcjellëse ti kthehen pronarit i cili posedon edhe leje valide.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 dhe nenit 452 par. 1 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin me shpenzimet e procedurës, të precizuara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, e po ashtu konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguaj taksën për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*